



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo



Komuna e Prishtinës
Opština Priština –Municipality of Prishtina

Në bazë të dispozitave të nenit 12, paragrafi 12.2, pika d e Ligjit nr. 03/ L – 040, për Vetëqeverisje Lokale (“Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës“, nr. 28/15 qershor 2008) dhe të dispozitave të nenit 34, paragrafi 34.1, pika d e Statutit të Komunës së Prishtinës, 01. nr. 110 – 391, të dt. 25.2.2010, Kuvendi i Kryeqytetit, në mbledhjen e mbajtur më 31.3.2026, merr këtë

V E N D I M
PËR NDARJEN E MJETEVE FINANCIARE KLUBIT TË BASKETBOLLIT TË FEMRAVE “PRISHTINA”

I.

MIRATOHET Vendimi për ndarjen e mjeteve financiare **KBF “Prishtina”**, për projektin **“Kërkesë për mbështetje financiare KBF “Prishtina”**.

II.

Shuma e mjeteve të ndara, sipas pikës I të këtij vendimi, është 25,000.00 € (njëzet e pesë mijë euro), shumë kjo e siguruar nga kodi buxhetor i Drejtorisë së Sportit 85086.

III.

Qëllimi i këtij Vendimi është ndarja e mjeteve financiare si në pikën II, në masovizimin e sportit, zhvillimin e vajzave të reja përmes akademisë së klubit, pjesëmarrjen aktive në garat zyrtare të FBK-së për grupmoshat e reja dhe afirmimin e basketbollit të femrave në Kosovë dhe rajon.

IV.

Pjesë e këtij vendimi është kërkesa me dokumentet përcjellëse, e **KBF “Prishtina”** dhe rekomandimi i komisionit.

V.

Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdesen Kryetari i Komunës dhe Drejtoritë e tjera relevante.

VI.

Ky vendim hyn në fuqi 30 (tridhjetë) ditën pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të Ministrisë së Administratës të Pushtetit Lokal, si dhe 7 (shtatë) ditë pas publikimit në gjuhët zyrtare në ueb-faqen e Komunës.

KUVENDI I KRYEQYTETIT
01-400/04-47978/26, më 02.4.2026

KRYESUES I KUVENDIT
Fehmi Kupina

